

## **FALËNDERIME**

*Do të doja të shprehja mirënjohjen dhe falënderimet e mia ndaj atyre që më kanë ndihmuar e mbështetur në realizimin e këtij punimi në mënyra të ndryshme.*

*Falënderimet më të përzemërta i drejtohen Prof. Dr. Hamlet Bezhani, udhëheqësit tim shkencor, për gatishmërinë dhe ndihmesën që më ka ofruar dhe për kohën e inkurajimin e vazhdueshëm.*

*Gjithashtu, falënderoj MA. Viktor Bakillari, këshillat e sugjerimet me shumë vlerë të të cilit, si dhe pasioni i tij për gjuhën, kanë qenë nxitje e vazhdueshme gjatë punës sime për realizimin e këtij studimi.*

*Falënderoj të gjithë koleget e mij në Fakultetin e Gjuheve të Huaja për mbështetjen e tyre morale dhe profesionale, e cila i dha shtysë cilësore këtij punimi.*

*Së fundi, këtë punim ia dedikoj familjes sime për mirëkuptimin, mbështetjen, përkrahjen dhe përkushtimin që kanë treguar për mua.*

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
<b>Parathënie</b> .....	<b>iii</b>
<b>Hyrje</b> .....	<b>vii</b>
<b>KREU I</b>	
Vështrim teorik dhe historik i formave të emëruara në gjuhë shqipe .....	<b>1</b>
1.1. Format e emëzimit në gjuhën shqipe .....	<b>1</b>
1.2. Format e emëzimit të mbiemrave, llojet e tyre .....	<b>4</b>
1.2.1. Mbiemrat dhe llojet e tyre .....	<b>4</b>
1.2.2. Emëzimi i mbiemrit .....	<b>4</b>
1.3. Emrat prejfoljorë asnjans .....	<b>16</b>
1.3.1. Format prejfoljore, shembuj nga autorë shqiptarë .....	<b>22</b>
1.4. . Emëzimi i përemrave pronorë .....	<b>24</b>
<b>KREU II</b>	
Funksionet e formave të emëruara në gjuhën shqipe .....	<b>26</b>
2.1. Në funksion kryefjale dhe kundrinori .....	<b>26</b>
2.2. Si përcaktorë të një emri tjetër .....	<b>26</b>
2.3. Si plotës të ndërtuar me parafjalë.....	<b>27</b>
2.3.1. Me parafjalën <b>nga</b> .....	<b>27</b>
Me parafjalët <b>me, më, në</b> , shoqëruar me nyjet <b>një, të</b> .....	<b>27</b>
<b>KREU III</b>	
Format e emëzimit në gjuhën gjermane. ....	<b>29</b>
3.1. Format e emëzimit në gjuhën gjermane .....	<b>29</b>
3.1.1. Emrat e prejardhur nga foljet .....	<b>30</b>
3.1.2. Njëpërmjet prapashtesave .....	<b>31</b>

3.1.3. Njëpërmjet parashtesave .....	34
3.1.4. Njëpërmjet vendosjes së nyjes para paskajores .....	35
3.2. Numrat themelorë si emra.....	36
3.3. Numrat rreshtorë .....	39
3.4. Veçoritë e mbiemrave të emëruar .....	40
3.5. A kanë të njëjtën mënyrë formimi format e emëruara në gjuhën shqipe dhe gjermane?...44	
3.6. Në ç' funksion janë përdorur format e emëruara në variantin shqip të veprës së Ismail Kadaresë “Pallati i Ëndrrave”? .....	45
3.7 Si i përgjigjen njëra - tjetrës format përkatëse në përkthim? .....	49
3.8 Në cilat raste format e njëres gjuhë nuk i përgjigjen tjetrës dhe si janë zëvendësuar apo përshtatur ato në përkthim? .....	52
3.9 Ndërveprimi dhe ndikimi i ndërsjellë i formave të emëruara në gjuhën shqipe nga ose njëpërmjet gjuhëve të tjera.....	57

#### **KREU IV**

Të shkruarit e formave të emëruara dhe emrave me shkronjë të parë të madhe në gjuhën shqipe dhe atë gjermane/ Großschreibung der Nominalisierungen in der albanischen und deutschen Sprache .....	67
<b>4.1</b> Të shkruarit me gërmë të madhe .....	67
<b>4.2</b> Grossschreibung .....	69
<b>4.3</b> Si të shkruaj? Me të madhe apo me të vogël?.....	73

#### **KREU V**

Format e emëruara në gjuhën shqipe dhe gjermane, bazuar në veprën e shkrimtarit Patrick Süskind, “Das Parfum” (Parfumi).....	76
5.1. Shembuj të formave të emëruara të marra nga romani “Parfumi” .....	76
5.2. Krahasimi i këtyre formave në të dyja gjuhët.....	79
5.3. Vështrim analitik bazuar në shembujt e nxjerrë nga romani “Parfumi” .....	110

## **KREU VI**

Formimi i emrave përmbledhës nga tema e shumësi.....	112
6.1. Veçoritë e emrave përmbledhës në gjuhën shqipe.....	112
6.1.1. Grupi i parë i emrave përmbledhës .....	112
6.1.2. Grupi e dytë, emrat përmbledhës që nuk e kanë të qartë shumësin .....	113
6.2 Kategoritë e emrave përmbledhës .....	116
6.2.1. Kufizimi i kuptimit përmbledhës dhe përfitimi i nuancave ose i kuptimeve plotësuese ..	117
6.3. Emrat përmbledhës në numrin shumës .....	119
6.4. Prapashtesat kryesore për formimin e emrave përmbledhës.....	123
6.5. Nyjembaresat e njëjësit të shquar .....	131
6.6. Rreth identitetit të gjinisë asnjësore në shqipen e sotme .....	131
6.7. Nënfishat semantike sipas tipave të .....	135
6.8. Përdorimi i fjalëve të emëruara në fjalitë e nënrenditura në gjuhën gjermane .....	158
<b>Përfundime</b> .....	<b>164</b>
<b>Bibliografia</b> .....	<b>171</b>

# HYRJE

## 0.1. Përlligja e punimit

*Gjuha ndodhet në një proces të pandërprerë zhvillimi, pasi ajo ka lindur bashkë me njerëzimin si një mjet shumë i rëndësishëm komunikimi dhe bashkë me të ndryshon, shndërrohet dhe zhvillohet në mënyrë të pandërprerë duke pasqyruar ndryshimet në veprimtarinë shoqërore, politike, ekonomike, kulturore dhe shkencore të vetë shoqërisë që e flet atë. Këto ndryshime dhe evoluime, pasqyrimin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë e gjejnë veçanërisht në leksikun e gjuhës, pasi janë fjalët ato që u përshtaten nevojave të bashkësisë shoqërore, duke i dhënë leksikut veçorinë që ndodhet në ndryshim e sipër më shumë se çdo anë tjetër e gjuhës. Një nga mjetet më të rëndësishme për zgjerimin e leksikut me fjalë të reja dhe emërtime të reja është fjalëformimi.*

*Emërzimi vepron mbi bazë modelesh, të cilat, duke kombinuar dhe bashkuar elementet bazë të gjuhës, krijojnë fjalë të reja. Ai u nënshtrohet rregullave të caktuara sintaksore, morfologjike e semantike, duke nxjerr në pah aftësinë e çdo gjuhe dhe folësve të saj për të formuar fjalë.*

*Ky punim trajton këtë sistem modelesh në përgjithësi, mbi bazën e të cilit janë formuar e formohen fjalë në çdo gjuhë, dhe fokusohet veçanërisht në dy nëndarje domethënëse të tij. Edhe pse gjuha shqipe dhe ajo gjermane u përkasin dy degëve të ndryshme të familjes gjuhësore indoeuropiane, në fjalëformim, veçanërisht në formimin e formave të emërzuar, ato dëshmojnë të kenë shumë karakteristika të përbashkëta.*

*Ky punim përqendrohet në dy nga nëndarjet e sistemit të emërzimit duke vënë theksin në analizën morfologjike, sintaksore dhe semantike të fjalëve të formuara, me dhe pa pjesëmarrjen e fjalëve shërbyese, në gjuhën shqipe, përqasur dhe krahasuar me ato të gjuhës gjermane. Edhe pse në të dyja gjuhët është shkruar shumë lidhur me këto çështje, bie në sy mungesa e punimve krahasuese mes tyre.*

*Mendojmë se një analizë e thelluar e formave të emërzuar në shqipe dhe gjermanishte është me interes jo vetëm në fushën e gjuhësisë krahasuese, por edhe në fushën didaktike, pasi u jep mundësi atyre që mësojnë gjuhën gjermane të kuptojnë më mirë mekanizmin e formimit të emrave dhe fjalëve substantivuara të gjermanishtes, në mënyrë që t'i zbërthejnë ato saktë gramatikisht e semantikisht, si dhe t'i përdorin në mënyrën e duhur.*

*Një rëndësi të veçantë merr analizimi i këtyre formave në fushën e përkthimit. Gjermanishtja njihet tashmë si një gjuhë e cila përdor stilin nominal dhe formon kompozita me qëllim sintetizimin e informacionit, ndaj dhe në shumë raste formohen fjalë qoftë edhe të sustantivuara mjaft të gjata, me shumë përbërës brenda, shqipërimi i të cilave kërkon një kompetencë shumë të mirë gjuhësore si dhe njohje të fjalëformimit në përgjithësi dhe modeleve të emërzimeve në veçanti.*

## **0.2 Objekti dhe hipotezat e punimit**

*Qëllimi i këtij punimi është që në kuadrin e një studimi përmasës e krahasues, të përshkruajë një pjesë të rëndësishme të fjalëformimit dhe kalimit nga një formë në një formë tashmë leksikisht të tjetërsuar të gjuhës shqipe dhe asaj gjermane, të cilat lidhen me fjalët foljore, mbiemërore, ndajfoljore, etj., të të dyja gjuhëve.*

*Duke pranëvënë dhe krahasuar sistemin fjalëformues në përgjithësi dhe substantivimin në veçanti të të dyja gjuhëve, hidhet dritë mbi të përbashkëtat dhe ndryshimet midis tyre.*

*Në këtë punim vihen në dukje ngjashmëritë dhe dallimet mes shqipes dhe gjermanishtes në këto çështje. Analizimi dhe përshkrimi i strukturës së formave të emëruara si ne shqip ashtu edhe ne gjermanisht, nxjerr ne dukje të përbashkat dhe veçorite specifikike të tyre. Gjithashtu analiza hedh dritë mbi modelet e krijuara për formimin e këtyre fjalëve në të dyja gjuhët, nxjerr në pah produktivitetin dhe aktivitetin e secilës prej tyre, si dhe ndriçon prirjet e gjuhës për formime modelesh të reja.*

*Kompozitat dhe fjalët e emëruara ngrihen mbi bazën e strukturave gramatikore, togjeve sintaksorë, të cilat janë vendimtare në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të formave të emëruara, ndaj është e nevojshme që këto struktura të kuptohen dhe të shpjegohen saktë nga mësimdhënësit, në mënyrë që dhe përvetësimi i tyre të jetë i suksesshëm.*

*Duke qenë se ky punim është një nga përpjekjet e pakta në krahasimin e modeleve të përmasjes në shqipe dhe gjermanishte, shpresojmë që përmes përshkrimit, analizimit, krahasimit, përkthimit, përfundimeve dhe hipotezave të hedhura në këtë punim, të kemi dhënë një ndihmesë sado modeste në pasurimin e mëtejshëm të fondit të botimeve krahasuese për këtë temë. Kjo do të jetë edhe një ndihmesë për të gjithë të interesuarit në fushën e gjuhësisë krahasuese, mësimdhënies së gjuhës gjermane dhe të atyre që shqipërojnë punimet e bëra në këtë gjuhë.*

## **0.3 Metodologjia dhe struktura e punimit**

*Ky është një punim i cili ka për qëllim analizimin dhe krahasimin e formave të emëruara si dhe produkteve të tyre në shqipe dhe gjermanishte, ndaj dhe metoda e përdorur është ajo përmasëse-krahasuese. Qasja është bërë duke pasur parasysh strukturën e fjalës së emëruar, marrëdhëniet sintaksore dhe semantike mes përbërësve të tyre si dhe lidhjen kuptimore.*

*Për realizimin e kësaj përmasjeje, është konsultuar një literaturë shumë e gjerë në të dyja gjuhët, duke filluar nga punime dhe studime, krahasime dhe përkthime të gjuhëlogëve dhe studjuesve gjerman dhe shqiptarë të gjitha triojeve.*

*Punimi përbëhet nga tri pjesë kryesore.*

*Në pjesën e parë jemi përpjekur të hedhim një vështrim të përgjithshëm, pa u ndalur në detaje, mbi sistemin e substantivimit të të dyja gjuhëve. Janë parë të gjitha mënyrat fjalëformuese që veprojnë në të dyja gjuhët, si dhe janë paraqitur në mënyrë të përgjithshme karakteristikat e*

*secilës prej tyre duke u ndalur vetëm në çështjet më thelbësore të tyre, shoqëruar për çdo rast me shembuj, nxjerrë nga studjuesit respektivë të dy gjuhëve. Për përmbushjen e qëllimit të punimit, nuk jemi mbështetur në formime ad hoc, por në materialin autentik vjelë nga botime apo vepra të përkthyer nga autorë gjerman dhe shqiptarë. Shembujt e marrë nga burime të tjera janë përdorur vetëm në ato raste kur në materialin e korpusit nuk janë gjetur mdërtime të përshtatshme për të paraqitur qartë qëllimin e tyre.*

*Në pjesën e dytë vijohet me një analizim të hollësishëm të çështjes së formave të emëruara në gjuhën shqipe dhe atë gjermane, duke nisur që nga qëndrimet e ndryshme që janë mbajtur ndër kohëra nga gjuhëtarë të ndryshëm, për të vazhduar më pas me përshkrimin dhe zbërthimin e përbërësve dhe tipareve që karakterizojnë këto dy mënyra fjalëformuese në shqipe dhe gjermanishte. Në këtë pjesë rëndësi i është kushtuar edhe çështjes së shkurtesave të formave të ndryshme të gjuhëve përkatëse.*

*Pjesa e tretë përbën dhe pjesën praktike të këtij punimi. Janë analizuar veprat e I.Kadaresë dhe Patric Sueskind, duke u bazuar kryesisht në emëzimet dhe njekohesisht duke parë të përbashkat dhe veçoritë për secilën gjuhë. Të gjitha përfundimet lidhur me analizimin dhe përjasjen e bërë janë trajtuar në një nënçështje më vete si për emëzimet, ashtu edhe për format e ndryshme në të dyja gjuhët.*

*Në fund janë dhënë disa përfundime të përgjithshme teorike dhe praktike për sistemin fjalëformues në përgjithësi dhe format e emëzura në veçanti, duke shpresuar në dhënien e një ndihmese për punime të mëtejshme mbi çështjet e trajtuara në këtë punim.*

*Në këtë studim do të parashtrohen në vija të përgjithshme strukturat e formave të emëzimit, mënyra e ndërtimit të tyre dhe funksionet e këtyre formave në secilën gjuhë. Do të shihet se ku përkojnë dhe ndryshojnë strukturat përkatëse nga njëra – tjetra dhe ç'vend zënë ato në përdorim.*

## **PUNIMI ANALITIK DO TË NDJEKË KËTË REND:**

1. Do të shihet denduria e përdorimit të secilës formë të emëruar në gjuhën shqipe dhe atë gjermane.
2. Çdo formë e emëruar e gjuhës shqipe do të krahasohet në kontekst me variantin e gjuhës gjermane, për të parë nëse në këtë variant është përdorur e njëjta formë e emëzimit apo jo.
3. E njëjta procedurë analitike do të ndiqet me tej duke u nisur nga konteksti në gjuhën gjermane, për të parë edhe në këtë rast përputhjet dhe mospërputhjet.
4. Analizën e përfundojmë me një renditje statistikore dhe përgjithësuese të formave përgjegjëse në secilën gjuhë në funksion të përgjigjes së pyetjeve:

- Në cilat raste formës përkatëse të shqipes i përgjigjet e njëjta formë në gjermanishte?
- Në cilat raste një formë e emëruar e gjuhës shqipe është përkthyer me një formë tjetër a emër në gjermanishte?
- Në cilat raste forma e emëruar e shqipes nuk është përkthyer fare?

Qëllim më vete i këtij punimi janë edhe pikat e renditura më poshtë.

- a) Për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme teorike – praktike të përdorimit dhe përkthimit e formave të emëruara në secilën gjuhë në rrafsh krahasues.
- b) Për të ndihmuar metodikisht kuptimin, përdorimin dhe përkthimin e ndërtimeve të emëruara nga shqipja në gjermanishte dhe anasjelltas.